



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action


RAPORTI I MONITORIMIT TË FUSHATËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës

14 shkurt, 2021



Mars, 2021



Raporti Përfundimtar i
Vëzhgimit të Zgjedhjeve:
Zgjedhjet e Parakohshme
për Kuvendin e Kosovës

**Raporti i Monitorimit
të Fushatës Zgjedhore:
Zgjedhjet e Parakohshme
për Kuvendin e Kosovës**

Raporti i Monitorimit të
Mediave Gjatë Fushatës
Zgjedhore: Zgjedhjet e
Parakohshme
për Kuvendin e Kosovës

Copyright ©2021 . Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Ambasadës Gjermane në Kosovë, Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Ambasadës së Zvicrës në Kosovë.

Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorit.

Demokracia në Veprim

Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 239

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 38 248 038

www.demokracianeveprim.org

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	6
Lista e figurave	7
Hyrje	8
Metodologjia	9
Historiku	10
Ndikimi i “Gjykatës Speciale” në fushatë zgjedhore	11
Monitorimi i Fushatës Zgjedhore	12
Aktivitetet zgjedhore sipas subjekteve politike, komunave dhe formave të organizimit	12
Respektimi i masave anti-COVID-19	16
Përdorimi i veturave zyrtare dhe prania e shërbyesve publik në fushatë	18
Mediat dhe atmosfera e përgjithshme e fushatës zgjedhore	19
Pjesëmarrja sipas gjinisë në fushatë	19
Infrastruktura për persona më aftësi të kufizuara	20
Prania e gjuhës së urrjetes në fushatë	21
Edukimi i votuesve nga subjektet politike	22
Programet politike dhe temat e diskutuara në fushatë zgjedhore	22
Rekomandimet	24

Lista e shkurtesave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
COVID-19	Sëmundja Koronavirus 2019
DnV	Demokracia në Veprim
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
KDTP	Partia Demokratike Turke e Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KKZ	Këshillat Komunal Zgjedhor
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Lista e figurave

Figura 1: Ngjarjet zgjedhore të paralajmëruara dhe të paparalajmëruara tek KKZ-të	12
Figura 2: Lloji i ngjarjeve të monitoruara në fushatë	13
Figura 3: Organizimi i ngjarjeve zgjedhore sipas komunave	14
Figura 4: Organizimi i ngjarjeve zgjedhore sipas subjekteve politike	15
Figura 5: Respektimi i masave anti-COVID-19 në ambiente të mbyllura	17
Figura 6: Respektimi i masave anti-COVID-19 në ambiente të hapura	17
Figura 7: Përdorimi i veturave zyrtare dhe prania e shërbyesve publik në fushatë	18
Figura 8: Prania e mediave dhe pengimi i mediave në fushatë zgjedhore	19
Figura 9: Pjesëmarrja sipas gjinisë në fushatë	20
Figura 10: Infrastruktura për persona me aftësi të kufizuara	20
Figura 11: Prania e gjuhës së urrëjtjes në fushatë	21
Figura 12: Edukimi i votuesve në fushatë	22
Figura 13: Temat e diskutuara gjatë fushatës zgjedhore	23

Hyrje

Për herën e pestë radhazi që nga shpallja e pavarësisë, Kosova shkoi përsëri në zgjedhje të parakohshme. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) caktoi datën 14 shkurt 2021 si ditën e zgjedhjeve, ndërsa vendosi që fushata zgjedhore të jetë prej dhjetë ditësh, përkatësisht nga 3 deri më 12 shkurt 2021, e cila u pasua me një ditë heshtje zgjedhore.¹ Në këto zgjedhje morrën pjesë në total 28 subjekte politike, prej tyre 21 parti politike, 2 koalicionë dhe 5 iniciativa qytetare.

Ky raport përmban të dhëna primare nga monitorimi i mbarëvajtjes së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës nga vëzhguesit afatgjatë të koalicionit Demokracia në Veprim (DnV).² Punimi është i organizuar në disa fusha. Së pari, shpjegon në mënyrë të detajuar strukturën dhe metodologjinë e punimit si dhe mënyrën e pranimit dhe procedimit të të dhënave nga vëzhguesit në terren. Ofron një historik të shkurtër i cili argumenton kontekstin e organizimit të zgjedhjeve të parakohshme. Gjithashtu, përfshinë ndikimin politik të "Gjykatës Speciale" në fushatë zgjedhore. Në fund, ofron informacionet kyçe nga terreni të cilat janë përmbledhur në pjesën kryesore të punimit "Monitorimi i fushatës zgjedhore", e cila është e ndarë në fusha specifike dhe ofron informacione kualitative dhe kuantitative për mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore dhjetë ditore.

Në përgjithësi, fushata zgjedhore ishte e qetë dhe pa ndonjë incident serioz. Një pjesë e konsiderueshme e ngjarjeve të organizuara nga subjektet politike nuk është raportuar në institucionet përkatëse. Aktiviteti më i zakonshëm gjatë fushatës ishin vizitat tek qytetarët, derë-më-derë si dhe vizita në institucione të caktuara. Këto aktivitete u shoqëruan me grumbullime të mëdha qytetarësh, duke mos respektuar rregullat për distancë fizike dhe mbajtjen e maskave në mënyrë të duhur. Gjithashtu, fushata u karakterizua me pjesëmarrje të ulët të grave në ngjarje të fushatës zgjedhore si pjesëmarrëse dhe si folëse. Tufje, kjo fushatë u karakterizua me elemente të gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, problem vazhdon të mbetet ofrimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuara në ambientet ku subjektet politike kanë zhvilluar aktivitetet e fushatës zgjedhore. Ndërkaq nuk kishte ndonjë pengesë për mediat dhe organizatat e shoqërisë civile që të vëzhgonin dhe të ndiqnin aktivitetet e fushatës.³

1 Kallxo.com, "Fushata zgjedhore nga 3 deri më 12 shkurt", 07 janar 2021.

2 Demokracia në Veprim është një koalicion i organizatave joqeveritare e themeluar në vitin 2007 e cila mbështetë promovimin e zgjedhjeve të lira si pjesën më thelbësore për një shoqëri demokratike. DnV promovon pjesëmarrjen në zgjedhje të lira përmes edukimit të votuesve; promovon të drejtën dhe obligimin e qytetarëve që të jenë pjesë e procesit zgjedhor; bashkëpunon me organizata vendore, rajonale dhe ndërkombëtare për ndërtimin e një procesi transparent dhe demokratik.

3 Demokracia në Veprim, "DnV: Fton qytetarët për pjesëmarrje në zgjedhje", 13 shkurt 2021

Metodologjia

Demokracia në Veprim (DnV) ka monitoruar fushatën zgjedhore me anë të angazhimit të 16 vëzhguesve në terren, të cilët kanë vepruar në shtatë komunat kryesore të Kosovës, Prishtinë, Mitrovicë e Jugut, Pejë, Prizren, Gjiilan, Ferizaj dhe Gjakovë, si dhe dy komuna me shumicë serbe, Mitrovica e Veriut dhe Graçanica, në periudhën kohore nga 3 shkurt deri më 12 shkurt 2021. Shumica dërrmuese e informacioneve të përdorura në këtë punim janë informata primare të marra drejtpërdrejt nga vendi i ngjarjeve dhe në raste specifike, programet politike dhe shpenzimet e subjekteve politike, janë marrë me shkrim nëpërmes kontaktit me email. Ndërsa një pjesë e vogël e informacioneve dhe citimeve në këtë raport janë sekondare.

Vëzhguesit kanë monitoruar mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore të subjekteve politike dhe kanë raportuar në baza ditore mbi ngjarjet e vëzhguara, takimet me subjektet politike, mbledhjet e Këshillave Komunal Zgjedhor (KKZ), si dhe parregullsitë e ndryshme të evidencuara gjatë fushatës zgjedhore. Vëzhguesit kanë plotësuar formularë specifik gjatë monitorimit, të cilat janë futur në një databazë dhe janë dërguar në qendër të DnV-së të skanuara së bashku me fotografi përkatëse, të cilat pastaj janë përdorur për verifikim dhe përpunim të informatave.

Në të gjithë formularët e vëzhguesve janë evidencuar të dhënat si: vendndodhja e ngjarjes/takimit (qyteti/komuna e ngjarjes), data dhe koha e fillimit dhe e mbarimit të ngjarjes/takimit, emri dhe mbiemri i vëzhguesit/es. Në formularin për monitorimin e ngjarjeve të subjekteve politike, vëzhguesit është dashur që të monitorojnë ngjarjen para fillimit, gjatë dhe pas mbarimit. Disa nga kategoritë e formularit përfshijnë:

- Aktivitetet e organizuara nga subjektet politike,
- Pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete zgjedhore,
- Mesazhet elektorale të subjekteve politike,
- Folësit në aktivitete sipas subjekteve politike,
- Përdorimi i resurseve publike në fushatë,
- Atmosfera e aktiviteteve zgjedhore,
- Prania e mediave gjatë aktiviteteve,
- Respektimi i masave anti-COVID-19.

Vëzhguesit e DnV-së gjithashtu kanë marrë pjesë në takimet e rregullta të KKZ-ve, për të marrë informata mbi ngjarjet e paralajmëruara nga subjektet politike, në mënyrë që të përcjellin këto ngjarje dhe të raportojnë nëse ngjarja e monitoruar ka qenë e paralajmëruar në KKZ apo jo nga subjektet politike.

Historiku

Kosova mbajti zgjedhje të parakohshme më 6 tetor 2020, e cila nxori fituese Lëvizjen Vetëvendosje (LVV) të pasuar shumë afër nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). LVV dhe LDK u dakorduan për koalicion qeverisës i cili zgjati vetëm 52 ditë. Mospajtimet mes partnerëve të koalicionit ishin të thella dhe shtyen LDK-në që të iniciojë mocion të mosbesimit për qeverinë, i cili kaloi me sukses në Kuvend. Si rezultat, Kosova u gjend para një krize të re institucionale, e tëra në mes të ballafaqimit me sëmundjen koronavirus 2019 (COVID-19).

Që nga votimi i mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, ish-Presidenti Hashim Thaçi dërgoi tre kërkesa me shkrim drejt LVV-së, si subjekt fitues i zgjedhjeve, për të kërkuar një emër të ri për mandatar për të formuar qeverinë. LVV nuk iu përgjigj asnjëherë kërkesave të presidentit dhe njëherit ishte e mendimit se vendi duhej të shkonte në zgjedhje pas rrëzimit të qeverisë.⁴ Meqë LVV nuk propozoi asnjë emër për mandatarin për kryeministër, Presidenti Thaçi kishte konstatuar se është konsumuar e drejta për mandatin e kandidatit, duke vijuar me mandatin e një kandidati tjetër. Pas zhvillimit të konsultimeve me subjektet politike, kërkesën për mandatarin e ri, Presidenti Thaçi e parashtroi tek LDK, subjekti politik i cili doli i dyti në zgjedhjet parlamentare të 6 tetorit 2019. LDK iu përgjigj pozitivisht kërkesës duke propozuar Avdullah Hotin si kandidat për kryeministër. Si rezultat, presidenti dekretoi Avdullah Hotin si mandatar për formimin e qeverisë, duke i hapur kështu rrugë krijimit të qeverisë së re. Më 3 qershor 2020, Kuvendi i Kosovës me 61 vota pro, 24 kundër dhe një abstenim, votoi qeverinë e re të Kosovës me kryeministër Avdullah Hotin.⁵

4 Radio Evropa e Lirë, "Thaçi sërish kërkon emrin e mandatarit nga Vetëvendosje", 15 prill 2020.

5 Bekim Shehu, "Parlamenti i Kosovës votoi qeverinë e re me kryeministër Avdullah Hotin", Deutsche Welle, 03 qershor 2020.

Mirëpo, procedura e votimit doli të jetë problematike. LVV deponoi një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në të cilën thuhej se vota e Etem Arifi nuk kishte pasur legjitimitet për faktin se ai ishte i dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me vendim të prerë. Deputeti Arifi është dënuar me një vit e tre muaj burgim nga Gjykata e Apelit për mashtrim me subvencione. Ndonëse i dënuar, Arifi kishte votuar pro formimit të qeverisë Hoti në seancën e 3 qershorit dhe vota e tij ishte vendimtare për formimin e Qeverisë Hoti.⁶

Më 22 dhjetor 2020, Gjykata Kushtetuese nxorri aktgjykimin për ankesën e LVV-së dhe konstatoi se vota e deputetit Etem Arifi për krijimin e Qeverisë Hoti ka qenë e pavlefshme. Si rezultat, Gjykata urdhëroi organizimin e zgjedhjeve brenda 40 ditësh. Presidentja në detyrë e Kosovës, Vjosa Osmani, shpërndau Legjislaturën e shtatë të Kuvendit të Kosovës, duke e caktuar 14 shkurtin datën e mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare.

Edhe pse u përcaktua të ketë fushatë zgjedhore prej dhjetë ditësh, subjektet politike filluan fushatën e tyre para aftatit zyrtar të përcaktuar nga 3 deri më 12 shkurt 2021. Mungesa e rregullimit ligjor ka krijuar hapësirë për të ashtuquajturën para-fushatë zgjedhore. Subjektet politike shfytëzuan këtë mundësi që të bëjnë fushatë të pa penguar duke shfrytëzuar resurse dhe duke organizuar aktivitete të ndryshme deri më 3 shkurt, kur edhe filloi zyrtarisht fushata zgjedhore.

6 Top Channel, "Gjykata Kushtetuese vendos! Kosova në zgjedhje brenda 40 ditësh", 21 dhjetor 2020.

Ndikimi i “Gjykatës Speciale” në fushatë zgjedhore

Në qershor të vitit 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, në kuadër të Dhomave të Specializuara, e njohur ndryshe si “Gjykata Speciale”, përmes një njoftimi për publikun bënë të ditur që ishte deponuar tek Dhomat e Specializuara një aktakuzë me dhjetë pika, në të cilin Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe persona të tjerë akuzohen për një sërë krimesh kundër njerëzimit dhe krime lufte ndër të cilat: vrasje e paligjshme, zhdukje e detyruar e personave, përndjekje dhe tortura.⁷

Ky lajm bëri bujë të madhe në Kosovë dhe krijoi një ndryshim drastik në diskursin publik duke e zhvendosur debatin rreth luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të bëmat e saj, si dhe dëmet potenciale që i po shkaktohen Kosovës nga Gjykata Speciale. Publikimi i aktakuzave vazhdoi përgjatë vitit duke përfshirë personalitete të njohura të UÇK-së sikurse Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe të tjerë, si dhe aktakuza të natyrës së pengimit të drejtësisë ndaj Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

Personat e akuzuar në fjalë janë gjithashtu persona me peshë politike. Hashim Thaçi, ish kreu i PDK-së, ka shërbyer si Kryeministër, Zëvendës Kryeministër, Ministër i Jashtëm dhe President i vendit, dhe është personi i cili ka lexuar deklaratën e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kadri Veseli, ish kryetari i PDK-së, dhe Jakup Krasniqi për një kohë kanë mbajtur pozitën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës. Gjithashtu, deputeti dhe shefi i grupit parlamentar të LVV-së, Rexhep Selimi, është një ndër personat e akuzuar.

Paraqitja e këtyre eksponentëve politik pranë Gjykatës Speciale në cilësinë e të akuzuarve pati ndikim të ndjeshëm edhe në fushatën zgjedhore. Në një anë, mungesa e tyre në aktivitete zgjedhore mund të ketë pasur ndikim në zbehjen e entuziazmit të mbështetësve të tyre, por në anën tjetër u përdor si arsye për të mobilizuar votuesit. Të paktën tri prej subjekteve politike: PDK, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe NISMA, të cilat njihen si parti të dala nga lufta, diskursin e tyre politik e zhvilluan në gjenezën e luftës çlirimtare dhe shfaqën përkrahje ndaj personave të akuzuar në Hagë. Konkretisht, AAK zgjodhi si sllogan “Forca e Kosovës”, ndërsa NISMA Socialdemokrate “Me çlirimtarët”, sllogane të cilat për qëllim kishin mobilizimin e elektoratit duke përdorur sentimentin patriotik dhe përkrahjen e luftës çlirimtare të Kosovës. “UÇK nuk është e kaluara, është themeli i shtetit. Ne jemi krenar me këtë trashëgimi dhe do ta mbrojmë atë. Me Çlirimtarët, këta jemi ne, kjo është ajo që na definon”, shkroi lideri i NISMA-s Fatmir Limaj në Facebook.⁸ Për dallim, PDK u fokusua në rimëkëmbje ekonomike, prandaj sllogani “Rimëkëmbje”, mirëpo diskursi mbi UÇK-në mbizotëroi si temë përgjatë fushatës elektorale.

7 Zyrat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, Deklaratë për Shtyp, 24 qershor 2020.

8 Zëri.info, “Me çlirimtarët”, sllogani i Nismës për zgjedhjet e 14 shkurtit”, 26 janar 2021.


Monitorimi i Fushatës Zgjedhore

Aktivitetet zgjedhore sipas subjekteve politike, komunave dhe formave të organizimit

Përgjatë fushatës zgjedhore, DnV ka vëzhguar 179 aktivitete zgjedhore, kryesisht të paralajmëruara pranë KKZ-ve. Subjektet politike kanë shkelur ligjin duke mos raportuar të gjitha ngjarjet e parapara gjatë fushatës zgjedhore në Komisionet Komunale Zgjedhore (KKZ) të komunave përkatëse siç parashihet me Planin Operacional të KQZ-së për sigurinë e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës.⁹

Përkundër obligimeve ligjore, subjektet politike kanë neglizhuar raportimin e një pjese të konsiderueshme

të ngjarjeve para mbajtjes së tyre. Në bazë të rregullores zgjedhore nr. 13, bazuar në nenin 44 dhe 62.2, pika (a) dhe (b) dhe nenit 128.2 të *Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme*, subjektet politike janë të obliguara që t'i paralajmërojnë të gjitha ngjarjet e fushatës së tyre zgjedhore në KKZ, në kushte normale 72 orë para mbajtjes së ngjarjes, apo në rast të zgjedhjeve të parakohshme si ato të 14 shkurtit, deri 24 orë para mbajtjes së ngjarjes.¹⁰ Sipas informacioneve të marra nga vëzhguesit në terren, vetëm 72.1% e ngjarjeve të monitoruara janë raportuar në KKZ, ndërsa pjesa tjetër prej 27.9% nuk janë raportuar fare.



⁹ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Vendim: Për miratimin e Planit Operacional të KQZ-së për sigurinë e Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 13 janar 2020.

¹⁰ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, "Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 – Fushata e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet Politike", 03 korrik 2013.

DnV ka parashtruar një kërkesë për të kërkuar informacion rreth numrit total të apeleve dhe ankesave. Sipas informatave të marra, numri i apeleve është 578, ndërsa i ankesave 21, apo 599 në total.¹¹ Sa i përket fushatës zgjedhore, janë parashtruar gjithsej 35 ankesa dhe dy apele. Ndërsa numri më i madh ankesave është parashtruar ne ditën e heshtjes zgjedhore, 102 sosh.¹²

Aktivitetet zgjedhore të subjekteve politike të monitoruara nga vëzhguesit e DnV-së përfshijnë: ecjet në sheshe; tubimet publike; takimet me grupe të shënjestruara; shtandet dhe vizitat derë-më-derë. Ndër to, tubimet publike dhe takimet me grupe të shënjestruara ishin format më të popullarizuara të aktiviteteve zgjedhore. Sipas raportimeve të vëzhguesve, subjektet politike kanë organizuar gjithsej 136 tubime publike, ndërsa takimet me grupe të shënjestruara kapin shifrën prej 33 sosh. Ngjarjet tjera nuk kalojnë numrin pesë, mirëpo duhet të ceket se një numër i konsiderueshëm i ecjeve nëpër sheshe nuk është raportuar fare në KKZ.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19 dhe masave në fuqi, fushata zgjedhore është zhvilluar me shumë në formën e vizitave derë-më-derë në grupe të vogla, të cilat kanë qenë problematike të vëzhgohen nga vëzhguesit e DnV-së, dhe si të tilla një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë raportuar në organin kompetent, përkatësisht KKZ. Me poshtë janë paraqitura ngjarjet e organizuara të cilat janë ndarë në kategori të veçanta:




FIG. 2 Lloji i ngjarjeve të monitoruara në fushatë

11 Informacion marrë përmes email nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
12 Ibid.

Një karakteristikë e veçantë rreth organizimit të ngjarjeve është fakti se numri i ngjarjeve në komuna jo domosdoshmërisht ka korresponduar me numrin e popullsisë në ato komuna. Nga të dhënat e marra nga vëzhguesit e DnV-së në terren, kryeqyteti ka një numër më të ulët të ngjarjeve të organizuara, 11 sosh, në kra-

hasim me komunën e Pejës dhe Prizrenit të cilat kanë 34 dhe 35 respektivisht. Numër të madh të ngjarjeve ka pasur edhe në komunën e Ferizajit, Gjilanit dhe Mitrovicës, ndërsa komunat tjera nuk kalojnë numrin 10. Nje pasqyrë e detajuar e numrit të ngjarjeve të monitoruara është paraqitur në grafën më poshtë:




FIG. 3 Organizimi i ngjarjeve zgjedhore sipas komunave

Ekziston një dallim sa i përket organizimit të ngjarjeve nga subjektet politike. LVV prin me organizimin e ngjarjeve me 58 në total, pasuar nga LDK me 44 dhe PDK me 35 ngjarje. Subjektet tjera nuk kalojnë numrin 20, ndërsa numri i ngjarjeve të organizuara është vetëm një për subjektet politike nga minoritetet, përjashtuar Listën Serbe e cila ka organizuar tetë ngjarje.

Ndërsa sa i përket organizimit të ngjarjeve nëpër komuna specifike, vërehet dallim mes subjekteve politike në raport me komunat në të cilat është fokusuar fushata e tyre zgjedhore. LVV ka organizuar më së shumti ak-

tivitete zgjedhore në komunën e Ferizajit dhe Prizrenit me nga 12 aktivitete respektivisht. Ngjarjet e LDK-së janë organizuar kryesisht në komunën e Pejës me 13 ngjarje dhe komunën e Gjilanit me 10 sosh. Ndërkaq, PDK nuk ka pasur ndonjë fokus kyç në ndonjë komunë specifike, megjithatë, prijnë komuna e Gjilanit me tetë aktivitete, pasuar me komunën e Mitrovicës dhe Prizrenit me shtatë aktivitete në total. Fokusi i AAK-së për organizim e ngjarjeve ka qenë komuna e Pejës me gjithsej nëntë ngjarje të organizuara.




FIG. 4 Organizimi i ngjarjeve zgjedhore sipas subjekteve politike

Nga numri i përgjithshëm i ngjarjeve të vëzhguara në të gjitha aktivitetet e subjekteve politike janë raportuar rreth 26678 pjesëmarrës në total.¹³ Mesatarisht, kanë

qenë rreth 149 pjesëmarrës për ngjarje. Në bazë të masave në fuqi për mbrojtje nga pandemia COVID-19,

¹³ Numri i pjesëmarrësve është bazuar në perceptimet e vëzhguesve

në terren, të cilët kanë determinuar numrin total të vëzhguesve në bazë të vlerësimeve të tyre individuale.

ky numër ka qenë relativisht i madh, veçanërisht duke marrë për bazë kufizimet e pjesëmarrësve në ambiente të mbyllura (deri në 30) dhe ambiente të hapura (deri në 50).

Problem vazhdon të mbetet publikimi i shpenzimeve në fushatë zgjedhore. DnV ka kërkuar nga subjektet politike për të kuptuar më tepër rreth shpenzimeve të subjekteve politike, megjithatë, vetëm tre subjekte politike i janë përgjigjur kërkesës, përkatësisht LVV, Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP) dhe Partia Fjala. Ndërsa subjektet e tjera politike nuk kanë shpërfaqur gatishmërinë e tyre për të treguar transparencë në financimin dhe shpenzimet e tyre.¹⁴

Respektimi i masave anti-COVID-19

Për shkak se këto zgjedhje u organizuan në kushte të jashtëzakonshme, në kohën kur vendi ende po ballafaqohet me pandeminë COVID-19, DnV ka përfshirë edhe një aspekt tjetër të vëzhgimit, se sa i kanë respektuar subjektet politike masat e qeverisë për menaxhimin e pandemisë. Tri ditë para ditës së zgjedhjeve, përkatësisht më 11 shkurt 2021, me kërkesë të Kryeministrit në detyrë, Avdullah Hoti, u miratua vendimi për lirim të masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19. Me vendimin e ri, ndër të tjera, u hoq ora policore dhe kufizimi i lëvizjes për komunat të cilat ishin në zonat e kuqe. Ndërsa, të gjithë operatorëve ekonomik në komunat që janë në zonën e kuqe, iu vazhdua lejimi i punës deri në ora 22:00.

DnV e priti me shqetësim këtë vendim në një kohë kur vendi po ballafaqohej me një rritje të vazhdueshme të personave të infektuar. Për më tepër, ky vendim i qeverisë ishte kontradiktore dhe diskriminues për faktin se vetëm qytetarëve të cilët jetojnë në Kosovë iu lehtësuan masat, ndërsa për qytetarët që jetojnë jashtë vendit, ato mbetën të njëjta – duke kërkuar nga ata që gjatë hyrjes në Kosovë të paraqesin testin negativ RT-PCR të bërë më së largu 72 orë përpara ose në të kundërtën të vetëizolohen për shtatë ditë.¹⁵

Për shkak se këto zgjedhje u organizuan në kushte të jashtëzakonshme, në kohën kur vendi ende po ballafaqohet me pandeminë COVID-19, DnV ka përfshirë edhe një aspekt tjetër të vëzhgimit, se sa i kanë respektuar subjektet politike masat e qeverisë për menaxhimin e pandemisë.

Megjithë lirim të masave, në pjesën dërrmuese të aktiviteteve zgjedhore, në ambiente të jashtme apo dhe të mbyllura, kufizimet anti-COVID-19 të rekomanduara nga institucioni relevant, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe të vendosura nga Qeveria e Kosovës, nuk janë respektuar. Subjektet politike kanë vazhduar me organizimin e aktiviteteve me numër të madh të qytetarëve, duke mos-përfillur kufizimet lidhur me numrin e lejuar të pjesëmarrësve. Në të njëjtën kohë, mos respektimi i distancës fizike dhe bartjes së maskave ka qenë e evidente në pothuajse të gjitha aktivitetet e monitoruara.¹⁶

Në ngjarjet e organizuara në ambientet e mbyllura është neglizhuar pothuajse totalisht respektimi i distancës, vetëm në 12 raste subjektet politike kanë respektuar distancën, që përbën një numër shumë të vogël. Nga 179 ngjarje të monitoruara, 78 ngjarje nuk kanë respektuar asnjë masë përfshirë këtu bartjen e maskave, respektimin e distancës, ofrimin e dezinfektuesve si dhe limitin e pjesëmarrjes së personave deri në 30.

14 Demokracia në Veprim, "DnV: Fushatë pa të dhëna për mënyrën e financimit të subjekteve politike", 9 shkurt 2021.

15 Reagim në rrjetin social Facebook, Demokracia në Veprim, "DnV: Qeveria të rishqyrtojë masat e reja anti-Covid të cilat mund të diskriminojnë votuesit që vijnë nga jashtë", 11 shkurt 2021.

16 Demokracia në Veprim, "DnV: Fushata zgjedhore dinamike, por pa përfillje të masave mbrojtëse kundër COVID-19", 6 shkurt 2021.




FIG. 5 Respektimi i masave anti-COVID-19 në ambiente të mbyllura

Ndërkaq në ngjarjet e organizuara në ambientet e hapura vërejmë respektim më të madh të rregullave të përcaktuara. Vetëm tetë raste janë evidentuar në të cilat nuk është respektuar asnjë masë dhe vetëm në shtatë raste nuk është respektuar distanca. Megjithatë, në të

dyja rastet ka shkelje të rregullave nga persona dhe subjekte politike të cilët kanë garuar për ta përfaqësuar sovranin, mirëpo në të njëjtën kohë kanë rrezikuar shëndetin publik.




FIG. 6 Respektimi i masave anti-COVID-19 në ambiente të hapura

Përdorimi i veturave zyrtare dhe prania e shërbyesve publik në fushatë

Legjislacioni në fuqi ndalon përdorimin e resurseve publike, financiare dhe njerëzore nga subjektet politike në pushtet, pasi që përdorimi i tyre krijon avantazh të dallueshëm dhe çrregullon parimin e garës së barabartë në mes të subjekteve. Sipas *Ligjit NR. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme*, përkatësisht neni 2 konstaton se “[P]ërdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal me qëllim të mbështetjes së një subjekti politik në zgjedhje është rreptësisht i ndaluar.¹⁷ Ndërsa në nenin 3 shpjegohet se çfarë nënkuptohet me burime: “[B]urime’ përfshijnë artikujt e prekshëm dhe të paprekshëm siç janë përcaktuar në rregullat e një institucioni, sikurse janë automjetet, materialet shpenzuese, fotokopja, telefoni, telefoni celular, pajisjet e zyrës, objektet.”¹⁸

Përdorimi i veturave zyrtare dhe prania e shërbyesve publik gjatë fushatës zgjedhore ka qenë kryesisht e ulët. Vëzhguesit e DnV-së kanë evidentuar numër të vogël të rasteve gjatë monitorimit të aktiviteteve në terren. Nga ngjarjet e monitoruara, janë raportuar nëntë raste të përdorimit të veturave zyrtare në fushatë. Këtë

vit ka pasur përparim të dukshëm krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2019 në të cilat përdorimi i veturave zyrtare është evidentuar në gjithsej 38 aktivitete.¹⁹

Tutje, janë evidentuar 19 persona të cilët janë shërbyes publik e që kanë marrë pjesë në fushatë zgjedhore. Numri i shërbyesve publik është më i lartë sesa përdorimi i veturave zyrtare. Edhe në këtë aspekt është vërejtur përmirësim i dukshëm krahasuar me zgjedhjet e vitit 2019, në të cilat janë evidentuar 124 raste të pjesëmarrjes së shërbyesve publik në fushatë.²⁰ Një pasqyrë e përgjithshme e përdorimit të veturave zyrtare dhe shërbyesve publik është përfshirë më poshtë:



FIG. 7 Përdorimi i veturave zyrtare dhe prania e shërbyesve publik në fushatë

17 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, 15 qershor 2008.

18 Ibid.


19 Demokracia në Veprim, "Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve: Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës", dhjetor 2019.

20 Ibid.

Mediat dhe atmosfera e përgjithshme e fushatës zgjedhore

Megjithë sfidat e krijuara nga pandemia COVID-19, masave në fuqi dhe mos-raportimin e ngjarjeve zgjedhore nga subjektet politike në KKZ, mediat kanë qenë të pranishme në shumicën e aktiviteteve të fushatës zgjedhore.

Nga informatat e marra në terren, mediat kanë qenë të pranishme në 103 ngjarje, nga 179 gjithsej, apo 58% të ngjarjeve. Në anën tjetër, nuk është evidentuar ndonjë rast i pengimit të mediave në fushatë zgjedhore. Më poshtë është paraqitur një graf që ilustron informatat e marra nga terreni:



Gjithashtu, atmosfera e ngjarjeve të organizuara nga subjektet politike ka qenë e qetë dhe nuk ka pasur ndonjë incident serioz. Nga 179 rastet e monitoruara, vetëm një rast është raportuar si "jo i qetë", rast i cili nuk ka ndikuar në atmosferën e përgjithshme të fushatës zgjedhore.

Pjesëmarrja sipas gjinisë në fushatë

Përfshirja dhe përfaqësimi i grave në fushatë zgjedhore ka vazhduar të jetë i ulët. Megjithë miratimin e ligjeve për përfaqësim më të madh të grave në institucione, përkatësisht *Ligjin për Barazi Gjinore* dhe *Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme*, kjo nuk po manifestohet me numër më të madh të pjesëmarrjes së grave në fushatë zgjedhore. Gjithashtu, përkundër premtimeve të shumta nga subjektet politike për hapësirë më të madhe për gratë, përfshirja e tyre ende mbetet në nivele të ulëta.

Sa i përket pjesëmarrjes së grave në fushatë zgjedhore dhe pjesëmarrjes së tyre si folëse nga subjektet politike që ato kanë përfaqësuar, vërehet një diskrepancë e theksuar me burrat. Në të dyja rastet, pjesëmarrja e grave në fushatë si dhe pjesëmarrja e tyre si folëse ka

qenë tejet e ulët, respektivisht nën 30%-shin e ngjarjeve të monitoruara.

Në rastin e parë, pjesëmarrja e grave në ngjarje të fushatës zgjedhore ka qenë tejet e ulët. Gratë kanë qenë prezente vetëm 24% në raport me burrat. Në rastin tjetër, vërejmë një rritje të lehtë të numrit të grave të cilat kanë qenë folëse gjatë fushatës zgjedhore, mirëpo kjo rritje është tejet e vogël në raport me pjesëmarrjen e përgjithshme të grave në ngjarjet e vëzhguara, ku gratë folëse të subjekteve politike kanë qenë vetëm 5% më lartë, apo 27% në raport me burrat. Numrat ishin relativisht të njëjtë edhe në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019. Në të gjitha aktivitetet e organizuara nga subjektet politike, vetëm 25.3% e folësve kanë qenë gra, derisa numri i pjesëmarrësve gra në fushatë zgjedhore ishte vetëm rreth 25%.²¹ Një pasqyrë e përgjithshme e pjesëmarrjes në nivel gjinor është përfshirë më poshtë:

21 Demokracia në Veprim, "Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve: Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës", dhjetor 2019.





FIG. 9 Pjesëmarrja sipas gjinisë në fushatë

Infrastruktura për persona më aftësi të kufizuara

Bazuar në të dhënat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH), vlerësohet se numri i personave me aftësi të kufizuara, përbën rreth 15% të popullsisë apo rreth 150,000-200,000 persona.²² Megjithatë, ofrimi i infrastrukturës për personat me aftësi të kufizuara vazhdon të mbetet sfida në Kosovë. Edhe gjatë kësaj fushate zgjedhore, DnV ka monitoruar qasjen dhe hapësirën që personat me aftësi të kufizuara kanë në aktivitetet zgjedhore, bazuar në të drejtën fundamentale të të gjithë qytetarëve për t'u informuar.

Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar një numër të lartë të ngjarjeve në të cilat personave me aftësi të kufizuara nuk u është ofruar infrastruktura minimale për të pasur qasje në ngjarje. Sipas raportimeve, rreth 31% të ngjarjeve të organizuara nga subjektet politike nuk kanë ofruar infrastrukturën e nevojshme për këta persona. Kjo përbën degradim të situatës krahasuar me zgjedhjet parlamentare të vitit 2019, në të cilat në 27.5% të aktiviteteve zgjedhore nuk është garantuar qasje fizike adekuate për personat me aftësi të kufizuara.²³



22 Grupi për Qasje në Zgjedhje, "Udhëzues për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje në proceset zgjedhore dhe politike", qershor 2016.

23 Demokracia në Veprim, "Raporti i Vëzhgimit të Zgjedhjeve: Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës", dhjetor 2019.

Prania e gjuhës së urrejtjes në fushatë


Gjuha e urrejtjes është e rregulluar me kushtetutë dhe kodin penal të Republikës së Kosovës. Sipas kushtetutës, përkatësisht neni 40, pika 2, “[L]iria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.²⁴ Ndërsa kodi penal në nenin 141 (Nxitja e përçarjes dhe mos durimit), pika 1, përkufion se, “[K]ushdo që nxit ose përhap publikisht urrejtje, përçarje dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore, fetare, etnike e të tjera, apo bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe karakteristikat e tjera personale, në mënyrën e cila mund të prishë rendin publik dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet”.²⁵

Gjuha e urrejtjes ka qenë relativisht prezente në fushatë zgjedhore. Sipas raportimeve të vëzhguesve në terren, janë raportuar 41 raste apo 22.9% në total nga rastet e monitoruara. Gjuha e urrejtjes ka qenë kryesisht në baza personale dhe politike. Në rastet e evidentuara është bërë thirrje që të mos votohen persona apo subjekte politike të caktuara të cilët nuk dëshirojnë të mbajnë raporte të mira me aleatët e Kosovës. Tutje, në disa raste, disa persona të subjekteve politike janë etiketuar si tradhtarë apo zhvatës të vendit. Në raste të

Sipas kushtetutës, përkatësisht neni 40, pika 2, “[L]iria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare”.

tjera, janë sulmuar persona të cilët kanë ndërruar subjektin politik. Gjithashtu, kundërshtarët politik nuk janë kursyer nga sulmet ad-hominem ndaj rivalëve të tyre.

Demokracia në Veprim, në kuadër të monitorimit të fushatës zgjedhore, ka parashtruar një sërë ankesash ndaj subjekteve politike. Prej tyre, dy të cilat janë aprovuar nga ana e PZAP-së, kanë pasur të bëjnë pikërisht me gjuhën e urrejtjes, e përdorur në dy spote nga subjektet politike AAK dhe NISMA, të cilat janë dënuar me nga 20 mijë euro gjobë secila.



24
25

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Edukimi i votuesve nga subjektet politike

Sa i përket edukimit të votuesve, subjektet politike nuk kanë qenë shumë të interesuara që ta edukojnë elektoratin e tyre se si të votojnë në ditën e zgjedhjeve. Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se vetëm në 55%

të rasteve të monitoruara subjektet politike janë marrë me edukim të votuesve. Në rastet e evidentuara, kandidatët e subjekteve politike janë fokusuar të edukojnë votuesit që të votojnë kandidatë specifik duke iu referuar numrave të tyre në listë.



Programet politike dhe temat e diskutuara në fushatë zgjedhore

Diskursi i fushatës zgjedhore është fokusuar kryesisht në çështje të brendshme veçanërisht ato ekonomike dhe të mirëqenies sociale. Konkretisht, 1) Zhvillimi ekonomik, bujqësia, dhe punësimi; 2) Arsimi; dhe 3) Sigurimet shëndetësore, pensionet dhe mirëqenia sociale ishin tri temat më të diskutuara në fushatë. Gjithashtu, temat sikurse kultura, rinia dhe sporti si dhe drejtësia dhe sundimi i ligjit ishin mjaft aktuale në fushatë.

Ndërkaq, është vërejtur një interesim tejet i vogël nga subjektet politike për të diskutuar rreth politikës së jashtme dhe dialogut Kosovë-Serbi. Kjo përbën një dallim të theksuar me fushatat e kaluara në të cilat premtimet dhe diskutimet rreth reciprocitetit me Serbinë, demarkimin e kufirit me Malin e Zi, liberalizimin e vizave apo anëtarësimin në organizata ndërkombëtare, të cilat tradicionalisht kanë pjesë kyçe të diskutimeve nga subjektet politike garuese. Forcat politike kryesore në vend, LVV, PDK, LDK dhe AAK, ndonëse me vonesë, kanë publikuar programet e tyre politike në faqet e

tyre zyrtare. LVV ka publikuar programin politik me prioritete të cilat bazohen në dhjetë fusha: arsimi dhe ekonomia; shëndeti publik; drejtësia; adresimi i krimeve të luftës; siguria publike; mbrojtja dhe forca e sigurisë së Kosovës; politika e jashtme; arti; trashëgimia kulturore dhe sporti.²⁶ Gjithashtu, PDK e ka publikuar programin e tyre qeverisës në faqen e tyre zyrtare të bazuar mbi politikën e rimëkëmbjes të bazuar në katër shtylla kryesore: Ekonomi; shëndetësi; sundim i ligjit dhe politikë e jashtme dhe imazh.²⁷ Tutje, LDK ka publikuar programin e tyre në faqen zyrtare të fokusuar në tetë pika kyçe: Zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës; shëndetësi; drejtësia/rendi dhe ligji; politikën sociale; politika e jashtme; arsimi dhe shkenca; mërgata dhe kultura, rinia dhe sporti.²⁸ Ndërsa, AAK është fokusuar në katër shtyllave: Ekonomia; siguria dhe sundimi i ligjit; mirëqenia dhe politika e jashtme.²⁹

26 Lëvizja Vetëvendosje, programi politik, shkurt 2021.

27 Partia Demokratike e Kosovës, programi politik, shkurt 2021.

28 Lidhja Demokratike e Kosovës, programi politik, shkurt 2021.

29 Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, programi politik, shkurt 2021.





FIG. 13 Temat e diskutuara gjatë fushatës zgjedhore

Rekomandimet

Në bazë të të gjeturave të vëzhgimit të fushatës zgjedhore, DnV ka dalë me disa rekomandime të cilat synojnë përmirësimin e mbarëvajtjes së fushatës zgjedhore, respektimin e dispozitave ligjore në fuqi, si dhe krijimin e kushteve më të favorshme për grupet e marginalizuara:

- Subjektet politike duhet t'i raportojnë aktivitetet e tyre zgjedhore siç përkufizohet me ligj, në kushte normale 72 orë para mbajtjes së ngjarjes, apo në rast të zgjedhjeve të parakohshme si ato të 14 shkurtit, deri 24 orë para mbajtjes së ngjarjes.
- Subjektet politike duhet t'i publikojnë programet e tyre politike me kohë, në mënyrë që ato të jenë të qasshme për të gjithë qytetarët.
- Subjektet politike duhet t'i bëjnë publike të gjitha shpenzimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore.
- Subjektet politike në pushtet duhet t'i përmbahen ligjeve në fuqi në lidhje me përdorimin e resurseve publike në fushatë zgjedhore (siç janë veturat zyrtare), veprime këto të cilat janë rreptësisht të ndaluara dhe krijojnë disavantazh ndaj subjekteve të tjera garuese.
- Kërkohet që subjektet politike në vend të krijojnë kushte më të favorshme dhe hapësirë më të madhe për gratë pjesëmarrëse dhe folëse përgjatë fushatës zgjedhore.
- Personave me aftësi të kufizuara duhet t'iu ofrohet infrastruktura e duhur fizike për qasje në secilin aktivitet të organizuar nga subjektet politike përgjatë fushatës zgjedhore.
- Kandidatët e subjekteve politike duhet t'i ndalin sulmet dhe ofendimet në baza personale, etnike, fetare dhe të tjera ndaj rivalëve të tyre politik. Gjuha e urrejtjes ndëshkohet me ligj dhe përkeqëson atmosferën e përgjithshme të fushatës zgjedhore dhe njëkohësisht mund të nxisë dhunë dhe urrejtje.
- Edhe pse këto zgjedhje u mbajtën në kohën kur vendi ende po ballafaqohet me pandeminë COVID-19 dhe gjasat që të përsëritet një situatë e tillë janë të vogla, megjithatë, subjektet politike kanë përgjegjësi publike dhe juridike dhe duhet t'i respektojnë të gjitha masat në fuqi dhe ta marrin seriozisht shëndetin publik të qytetarëve.
- Vendimet e marra nga qeveria në prag të zgjedhjeve duhet të marrin parasysh edhe qytetarët të cilët jetojnë jashtë vendit në mënyrë që të evitohen vendime kontradiktore dhe diskriminuese.



Federal Department of Foreign Affairs FDFA